



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.5623/2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr. 03L/1-048 neni 20, Ligji mbi Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-49 neni 2, Qarkorja Buxhetore 2017/01 për Komuna Nr.01/966 e datës 13.05.2016, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 75, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 23.06.2016 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITET 2017-2019

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2017-2019 e cila përmban planifikimet buxhetore nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake, për vitin 2017 buxheti është në lartësi prej **2,100,573 €**, ndërsa projeksionet për vitin 2018 janë në shumë prej **2,150,729 €** dhe për vitin 2019 janë në shumë prej **2,193,062 €**.

II

Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin 2017 sipas pikës I të këtij vendimi, mjetet nga grantet qeveritare janë në shumë prej 1,860,719 €, që shënojnë pjesëmarrje në shumë prej 88.58%, ndërsa nga të hyrat vetanake komunale në shumë prej 239,854 € apo 11.42%.

III

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2017 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje: Paga dhe mëditje 1,397,228 €, Mallra dhe shërbime 180,200 €, Shpenzime Komunale 48,500 €, Subvencione dhe transfere 54,000 € dhe Shpenzime kapitale 420,645 €.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

V

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Buxhet dhe Financa, Ministria e Financave – Departamenti i Buxhetit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 23. 06. 2016

Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava



01/Nr. 6327/2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 23.06.2016 merr:

V E N D I M
PËR HEQJEN E PROJEKTIT NGA LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për heqjen e projektit nga lista e projekteve kapitale të kornizës afatmesme buxhetore 2017-2019.

II

Duke ju referuar nenit I të këtij vendimi nga lista hiqet projekti me numër 39 (tridhjetë e nëntë) , Instalimi i nxehtës qendrore në shtëpinë e kulturës "Imri Curri" dhe mjetet financiare transferohen në projektin për bashkëinvestime.

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të kuvendit, ndërsa do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 23. 06. 2016



***Kryesuesi i Kuvendit**
Qamush Brava